



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE  
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

**VENDIM**  
Nr.57 , datë 29.12.2017

**PËR**  
**NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR**  
**RREGULLATOR NR. 13, DATË 30.03.2017 "MBI TARIFAT E UJIT PËR KONSUM**  
**PUBLIK PËR SHOQËRINË UK BERAT - KUÇOVË"**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 09.12.2015 "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 09.12.2015 "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 09.12.2015 "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 09.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura", Komisioni Kombëtar Rregullator,

**VENDOSI:**

1. Në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 13, datë 30.03.2017, "Për tarifat e ujit për konsum publik për shoqërinë UK Berat - Kuçovë sh.a. bëhen ndryshimet e shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 1 pas pikës "b" shtohen pikat "c", "ç" dhe "d", si më poshtë:

**"c. Tarifat Volumetrike**

Kategoria e shërbimit	Njësia	Njesitë Administrative	
		Otlak, Velabisht, Sinje, Kozare, Lumas	Roshnik
<b>a. Për shërbimin e furnizimit me ujë</b>			
1. Konsumatore familjarë	lek/m <sup>3</sup>	50	40
2. Konsumatore publik	lek/m <sup>3</sup>	150	150
3. Konsumatore private	lek/m <sup>3</sup>	150	150
<b>b. Për largimin e ujërave të ndotura</b>			
1. Konsumatore familjarë	lek/m <sup>3</sup>	14	14
2. Konsumatore publik	lek/m <sup>3</sup>	24	24
3. Konsumatore private	lek/m <sup>3</sup>	24	24

**ç. Tarifa e shitjes së ujit me shumicë**

Për UK Poliçan 5.4 lek/m<sup>3</sup>

**d. Tarifa fikse**

Kategoria e Konsumatorëve	Njësia	Njësiti Administrative
		Otlak, Velabisht, Sinje, Kozare, Lumas, Roshnik
1. Konsumatore familjarë	lek/m <sup>3</sup>	100
2. Konsumatore publik	lek/m <sup>3</sup>	200
3. Konsumatore private	lek/m <sup>3</sup>	200

b) Pika 2 e vendimit ndryshon si më poshtë:

2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2018 janë si më poshtë:

Treguesit e Performancës	Viti 2018
Mbulimi me ujë	78%
Mbulimi me kanalizime	62%
Niveli i Matjes	67%
Uji pa te ardhura	65%
Norma e arkëtimit	86%

2. Ky vendim hyn në fuqi më 01.01.2018 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

**K R Y E T A R I**

**Ndriçim SHANI**